



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA- REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Priljeni/Prodato Received/Delivety	09.06.2023	3	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Bri Prot Prot No	Shtojca Pilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHKCK	4663	2023	1/7



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.631/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-Kryetar, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Çlirim Zeka -Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.631/2022 të datës 12.04.2023 të parashtruar nga ankuesja kundër Vendimit të Komisionit Vlerësues për lëvizje brenda kategorisë të Komunës së Prishtinës, në çështjen juridike "Kontestim Konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 nën paragrafi 1.1, dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 09.06.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.631/2023 e datës 12.04.2023 e parashtruar nga ankuesja
- II. Anulohet Konkursi për pranim me numër reference RN00011416 për emrin e grupit "Specialist të marrëdhënieve me publikun për informim"-Zyrtar i Lartë për Komunikim me Publikun" i shpallur me datë 06.04.2023 nga Komuna e Prishtinës, si dhe çdo veprim tjetër administrat qe rrjedhë nga kjo procedurë e pranimit.
- III. Anulohet Vendimi i datës 31.03.2023 i Komisionit të Vlerësimit, Renditja përfundimtare e kandidatëve e datës 23.03.2023 si dhe Njoftimi i datës 31.03.2023 për përfundimin e procedurës së lëvizjes brenda kategorisë me numër referencë RN0001101 për pozitën e punës "Zyrtar i Lartë për Komunikim me Publikun" .
- IV. Mbetet në fuqi Konkursi për Lëvizje brenda Kategorisë me numër reference RN00011001, për pozitën e punës "Zyrtar i Lartë për Komunikim me Publikun" në Komunën e Prishtinës si dhe



Njoftimi për përzgjedhjen në listën e ngushtë i datës 13.03.2023, **ndërsa çështja kthehet** në fazën e vlerësimit të Komisionit për Vlerësim për lëvizje brenda kategorisë.

**V. Obligohet** Kryetari i Komunës së Prishtinës dhe Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Prishtinës, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditës nga dita e pranimit të këtij vendimi, të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme me qëllim të zbatimit të këtij vendimi siç përcaktohet në pikën II, III dhe IV të dispozitivit.

**VI.** Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

### A r s y e t i m

Ankuesja më datë 12.04.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 3474/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës kundër Vendimit të Komisionit Vlerësues për lëvizje brenda kategorisë i Komunës së Prishtinës të datës 31.03.2023, me pretendimet ankimore që vlerësimi i ankueses nga Komisioni i Vlerësimit është i padrejtë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 10.05.2023 përmes e-mailit ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Prishtinës, ndërsa Këshilli më datë 17.05.2023 ka pranuar përgjigje në ankesë nga Komuna e Prishtinës, me shkresat e bashkangjitura.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka nxjerrë Vendimin me numër VK/2023 me datë 26.05.2023 sipas të cilit i është vazhduar afati ankesës së ankueses edhe për dhjetë (10) ditë pune.

**Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova:** Ankesën e ankuesit me numër protokollit 3474/2023 të datës 12.04.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Konkurs Lëvizje brenda kategorisë me numër reference RN00011001 i datës 14.02.2023; CV-ja e A.L.; Aplikacionet nga HRMIS; Njoftim nga simbnj për A.L. i datës 04.03.2023; Njoftim nga simbnj për A.L. i datës 13.03.2023; Njoftim nga burimet njerëzore i datës 20.03.2023; Njoftim nga simbnj për A.L. i datës 23.03.2023; Njoftim nga simbnj për A.L. i datës 23.03.2023; Njoftim nga simbnj për A.L. i datës 03.04.2023; Njoftim nga simbnj për A.L. i datës 03.04.2023; Rezultatet e verifikimit paraprak të datës 13.03.2023; Rezultatet e vlerësimit të datës 22.03.2023; Rezultatet e vlerësimit të datës 23.03.2023; Rezultatet përfundimtare të vlerësimit të datës 03.04.2023; Njoftim nga Njësia e Burimeve Njerëzore i datës 13.03.2023; Njoftim nga Njësia e Burimeve Njerëzore i datës 23.03.2023; Njoftim nga Njësia e Burimeve Njerëzore i datës 31.03.2023; Ankesë e ankueses drejtuar Komisionit të vlerësimit e datës 27.03.2023; Vendim i Komisionit Vlerësues për Lëvizje Brenda Kategorisë i Komunës së Prishtinës i datës 31.03.2023; Konkurs pranim i hapur me numër



reference RN00011416 i datës 06.04.2023; Vërtetim për statusin e studentit A.L. me numër Ref.nr.04/3460 i datës 29.09.2020; Certifikatë e notave nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" e A.L. me numër Ref.nr.04/3573 i datës 30.09.2020; Certifikatë e notave nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" e A.L. me numër Ref.nr.04/3911 i datës 16.10.2020; Diplomë nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" e A.L. me numër Nr.373 i datës 07.09.2016; Pasqyrë e notave nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" e A.L. me numër Nr.prot.04/3514 i datës 30.09.2020; Diplomë nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" e A.L. me numër Nr.2037 i datës 10.10.2013; Akt Emërim i A.L. i datës 21.01.2015; Ndryshimi dhe plotësimi i akt emërimit i A.L. i datës 14.01.2015; Vendim nga Njësia e Burimeve Njerëzore e Komunës së Pejës për A.L. me Nr.01-112/01-0093784/22 i datës 22.08.2022; Kontratë pune nga Universiteti "Ukshin Hoti" për A.L. i datës 08.04.2021; Kontratë pune nga Universiteti "Ukshin Hoti" për A.L. i datës 01.12.2020; Kontratë pune nga Universiteti "Haxhi Zeka" i datës 01.03.2018; Kontratë pune nga Universiteti "Haxhi Zeka" i datës 02.03.2017; Kontratë pune nga Universiteti "Haxhi Zeka" i datës 04.11.2016; Vërtetim pune nga gazeta "nacional" për A.L. me nr.11/04 i datës 27.11.2014; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm, i ulët dhe profesional i A.L. i datës 16.01.2023; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm, i ulët dhe profesional i A.L. i datës 25.01.2022; Vërtetim nga Njësia e Burimeve Njerëzore e Komunës së Pejës për A.L. i datës 01.03.2023; Certifikatë mbi dënimet penale e A.L. i datës 01.03.2023; Certifikatë nga CDAEFF për A.L. i datës 21.08.2016; Shkresë me titull rinia dhe punësimi e A.L.; Certifikatë nga IKAP për A.L. i datës 15.11.2016; Certifikatë nga KAS për A.L. i datës 25.03.2017; Certifikatë nga osce për A.L. i datës 04.10.2017; Certifikatë nga EU për A.L.; Certifikatë nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" për A.L. i datës 21.07.2018; Certifikatë nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" për A.L. i datës 11.07.2019; Certifikatë nga Universiteti i Tetovës i A.L. i datës 26.09.2019; Certifikatë nga qendra shqiptare e studimeve letrare "Pjeter Budi" për A.L. i datës 03.09.2020; Seminari ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare, revistë nr. 39; Certifikatë nga IJSR për A.L. i datës 06.06.2022; Kërkesë për përgjigje në ankesë përmes e-mailit e datës 10.05.2023; Përgjigje në ankesë e datës 17.05.2023; Njoftim nga Burimet Njerëzore i datës 20.03.2023; Vendim për themelimin e komisionit për vlerësim për lëvizje brenda kategorisë me numër 14-020/04-53705 i datës 13.03.2023; Lista e aplikantëve; Aplikacioni i A.L. i datës 04.03.2023; Shkresë nga ICHSSA me numër ISBN:978-608-217-113-5 i datës 18.11.2022; Certifikatë nga Universiteti i Tetovës për A.L. i datës 18.11.2022; Seminari XL ndërkombëtar për gjuhën letërsinë dhe kulturën shqiptare i datës 26.08.2022; Fotografi e A.L.; Certifikatë nga IJSR për A.L. i datës 06.06.2022; Letërnjoftim i A.L.; Renditja përfundimtare e kandidatëve nga SIMBNJ i datës 23.03.2023; Vendim i KPMSHCK me numër VK/2023 i datës 26.05.2023;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës ka konstatuar se ankesa e ankueses **është e bazuar, sepse:**

Nga administrimi i provave materiale, Kolegji ka gjetur se Komuna e Prishtinës, më datë 14.02.2023 ka publikuar njoftimin për shpallje të konkursit me Nr. Reference:RN00011001 për lëvizje brenda kategorisë për pozitën "Zyrtar i Lartë për Komunikim me Publikun", ku afati për aplikim ka rrjedh nga data 01.03.2023 deri 08.03.2023. Në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesja e cila është përfshirë në listën e ngushtë për të vazhduar me fazën e intervistës me gojë. Bazuar në listën e aplikantëve rezulton se numri i kandidatëve ka qenë tre (3). Ndërsa



bazuar në njoftimin e datës 13.03.2023 të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Prishtinës kriteret për të vazhduar tutje i plotësojnë të tre (3) kandidatët.

Më datë 22.03.2023 është mbajtur intervista me gojë për kandidatët, ku rezulton se nga lista përfundimtare ankuesja është vlerësuar me gjithsejtë 32.2 pikë, ndërsa ankuesja më datë 23.03.2023 është njoftuar për rezultatin si dhe është njoftuar për të drejtën e ankesës. Ankuesja më datë 27.03.2023 ka parashtruar ankesë pranë Komisionit të Vlerësimit për Lëvizje Brenda Kategorisë të Komunës së Prishtinës, ndërsa ky i fundit përmes Vendimit të datës 31.03.2023 ka refuzuar ankesën e ankueses duke konstatuar që vlerësimi nga komisioni ka qenë sipas përgjigjeve të dhëna në intervistë.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër vendimit të datës 31.03.2023 të Komisionit të Vlerësimit për Lëvizje Brenda Kategorisë të Komunës së Prishtinës, pretendon se Komisioni Vlerësues nuk e ka vlerësuar drejtë dhe se 20 pikë mund ti ketë vetëm nga biografia e saj dhe se e njëjta ka dorëzuar dokumente të mjaftueshme që dëshmojnë përgatitjen profesionale dhe përvojën e punës dhe kërkon masë të përkohshme për pezullimin e konkursit aktual të jashtëm të njoftimit 06.04.2023 të Komunës së Prishtinës.

Sipas Konkursit me numër reference RN00011001 për lëvizje brenda kategorisë, për pozitën e punës "Zyrtar i Lartë për Komunikim me Publikun" si kushte për lëvizjen brenda kategorisë janë përcaktuar: *Të jetë nëpunës civilë i të njëjtës kategori për të cilën aplikon; Të jetë nëpunës civil i konfirmuar në detyrë në rastin e lëvizjes brenda kategorisë profesionale; Të mos jetë ndëshkuar me ndonjë masë disiplinore që nuk është shuar ende; Të jetë vlerësuar të paktën 'mire' për rezultatet në punë, të paktën gjatë dy viteve të fundit të vlerësimit; Në rastin e konkurrimit për lëvizje brenda kategorisë profesionale të jetë vlerësuar të paktën mirë në vitin e fundit.* Ndërsa në kërkesat e përgjithshme formale janë përcaktuar: *Arsimimi i kërkuar: Diplomë/a a arsimit të lartë së paku 3 vite të studimeve. Diplomë e nivelit pestë të Korniza Kombëtare e Kualifikimeve (KKK), për profesione deficitare (TIK); Kualifikime të posaçme formale janë përcaktuar: Gazetari/Shkenca Komunikimi, Gjuhë dhe Letërsi, Marrëdhënie me Publikun, Marketing. Certifikata, licenca kur kërkohen me legjislacionin në fuqi apo kur vlerësohet se janë të nevojshme për pozitën e kësaj klase.* Përvoja e punës e kërkuar: *Së paku dy (2) vite përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.*

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankueses, Kolegji i Këshillit i'u referua dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë të cilat rregullojnë procedurën e lëvizjes brenda kategorisë, gjegjësisht nenit 38 të këtij ligji me të cilin është përcaktuar se: *"1. Plotësimi i pozitave të lira në kategorinë profesionale, të ulët dhe të mesme drejtuese, bëhet së pari nga nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, nëpërmjet procedurës së lëvizjes brenda kategorisë. 2. Nëpunësit civilë të së njëjtës kategori në kuadër të Shërbimit Civil, që i plotësojnë kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e posaçme për vendin e lirë, mund të aplikojnë për plotësimin e një vendi të lirë, nëpërmjet procedurës së lëvizjes, sipas paragrafit 1 të këtij neni". ...5. Vlerësimi i kandidatëve të interesuar kryhet nga një komision vlerësimi, i krijuar në çdo institucion, bazuar në një intervistë me kandidatët. Komisioni përbëhet nga pesë anëtarë, njëri nga të cilët është domosdo përfaqësues i Njesisë së Burimeve Njerëzore të institucionit. 6. Në përfundim të vlerësimit, Komisioni mund të vendosë: 6.1. përzgjedhjen*



e kandidatit më të suksesshëm për t'u emëruar në vendin e lirë, apo; 6.2. përfundimin e procedurës, pa asnjë të përzgjedhur, në rast se asnjë nga kandidatët e interesuar nuk vlerësohet i suksesshëm.

Po ashtu, Kolegji ka analizuar edhe dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, përkatësisht: Nenin 44 me të cilin është përcaktuar se: "1.Konkurimi për lëvizjen brenda kategorisë zhvillohet në dy faza: 1.1. verifikimi paraprak i kandidatëve; dhe 1.2. vlerësimi i kandidatëve. 2.Verifikimi paraprak kryhet nga NJBNJ, ndërsa vlerësimi i kandidateve kryhet nga Komisioni i Vlerësimit për lëvizjen brenda kategorisë, krijuar sipas nenit 47 të kësaj Rregulloreje 3.Dispozitat, për procedurën e pranimit në shërbimin civil, të kësaj Rregulloreje, do të zbatohen përshtatshëmrisht edhe për procedurën e konkurimit për lëvizjen brenda kategorisë, për aq sa nuk përcaktohet shprehimisht ndryshe në këtë pjesë të kësaj rregullore", nenin 47 me të cilin përcaktohet se: "1.KVLBK zhvillon një intervistë me gojë me kandidatët. 2.Nëpërmjet intervistës, KVLBK vlerëson jetëshkrimin/CV, njohuritë, aftësitë apo cilësitë e kërkuara për pozitën e punës për të cilën zhvillohet konkurrimi. 3.KVLBK përgatit përpara fillimit të intervistës një grup pyetjesh. Intervista që zhvillohet është e strukturuar dhe me pyetje të njëjta për të gjithë kandidatët e cila përgatitet në ditën e zhvillimit të intervistës.. 4.Vlerësimi maksimal në intervistën me gojë është njëqind (100) pikë", nenin 48 me të cilin përcaktohet se: "...Pikët e çdo anëtari për çdo vlerësim mbledhen dhe pjesëtohen me pesë. 2.Në përfundim të fazës të vlerësimit, pikët e përfituara nga secili kandidat në secilën nga hapat e vlerësimit, mbledhen dhe shuma e pikëve për të gjithë hapat e vlerësimit përbën vlerësimin përfundimtar të konkurrimit", si dhe nenin 49 me të cilin përcaktohet se: "1.KVLB në përfundim të fazës së vlerësimit të kandidatëve, harton dhe miraton një listë me vlerësimet përfundimtare të të gjithë kandidatëve. Kandidatët renditen në listë sipas rezultatit të vlerësimit përfundimtar në rendin zbritës. Lista i dërgohet Njesisë Përgjegjëse brenda njëzetë e katër (24) orëve nga miratimi i saj. 2.Kandidati që është vlerësuar me më shumë pikë dhe që ka marrë të paktën gjashtëdhjetë (60) pikë është kandidati fitues dhe ka të drejtën të emërohet në pozitën e lirë për të cilën është zhvilluar konkurimi. 3.Nëse asnjë nga kandidatët nuk është vlerësuar me gjashtëdhjetë 60 e më shumë pikë, procedura e lëvizjes brenda kategorisë përfundon pa kandidat fitues".

Duke u bazuar në dispozitat si më lartë, e në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankueses, Kolegji i Këshillit ka analizuar provat materiale të çështjes në procedurë dhe si rrjedhojë ka konstatuar se lidhur me procedurën e vlerësimit të kandidateve bazuar në intervistën me gojë, ekziston vetëm shkresa me emërtimin "Renditja Përfundimtare e Kandidatëve", e datës 23.03.2023 e cila përmban vetëm një listë me pikët e përgjithshme të kandidatëve, duke mos evidentuar asnjë detajë lidhur me rrjedhën e kësaj procedure dhe në veçanti lidhur me mënyrën e vlerësimit të kandidatëve nga anëtarët e Komisionit. Andaj, mbi bazën e këtyre fakteve, Kolegji i Këshillit vlerëson se Komisioni i Vlerësimit për lëvizje brenda kategorisë i Komunës së Prishtinës, ka vepruar në kundërshtim me ligjin material konkretisht nenit 44 paragrafi 3 lidhur me nenin 25 paragrafi 1 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, rrjedhimisht Kolegji i Këshillit ka konstatuar se Komisioni i Vlerësimit në përfundim të fazës së vlerësimit të kandidatëve, nuk ka hartuar dhe miratuar aktin e përfundimit të procedurës të konkurrimit edhe një listë me vlerësimet përfundimtare të të gjithë kandidatëve ashtu siç përcaktohet me dispozitat e nenit 25 paragrafi 1 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.





Po ashtu Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen ankesave lidhur me pretendimin ankimor të ankueses që Këshilli të marrë masë të përkohshme për pezullimin e konkursit të jashtëm sipas njoftimit të datës 06.04.2023 për pozitën "Zyrtar i Lartë për Komunikim me Publikun" në Komunën e Prishtinës deri në zgjidhjen meritorë të ankesës së saj në Këshill. Kolegji fillimisht ka konstatuar se ankuesja ka shterur mjetet e brendshme juridike në Konkursin Lëvizje brenda kategorisë për pozitën "Zyrtar i Lartë për Komunikim me Publikun" në Komunën e Prishtinës me ankesë, pastaj me datë 12.04.2023 ka parashtruar ankesë në Këshill.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka analizuar dispozitat e Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik konkretisht nenin 24 paragrafin 3 ku përcaktohet se: 3. *Nëpunësi civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil sipas këtij ligji. E drejta e ankimit në KPMSHC i njihet edhe çdo kandidati në një procedurë pranimit në Shërbimin Civil. Pas shterimit të drejtës së ankimit në KPMSHC, mund të iniciohet konflikt administrativ në gjykatën kompetente për çështjet administrative si dhe Rregulloren 16/2020 për pranimin dhe karrierën në shërbimin civil të Republikës së Kosovës gjegjësisht neni 31 paragrafi 1 dhe 2 ku përcaktohet se: 1. Kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil, i cili është i pakënaqur me vendimin e organit të punësimit, ka të drejtë të parashtrorë ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil (në vijim në tekstin e kësaj Rregullore "Këshilli") . 2. Ankesa në Këshill parashtrorë vetëm pas shterimit të procedurës të brendshme të ankesës të organit përkatës që ka nxjerrë aktin apo kryer veprimin që kundërshtorë. Andaj mbi bazë të elaborimit të bazës ligjore të lartcekur Kolegji ka konstatuar se Komuna e Prishtinës me rastin e shpalljes së Konkursit për pranim sipas njoftimit të datës 06.04.2023 me nr. Reference RN00011416 me emrin e grupit Specialist të marrëdhënieve me publikun për informim për pozitën "Zyrtar i Lartë për Komunikim me Publikun" në Komunën e Prishtinës ka vepruar në kundërshtim me nenin 130 paragrafin 1 të Procedurës së Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: 1. Përveçse kur parashikorë ndryshe me ligj, parashtrimi i një ankese pezullon, sipas fuqisë së ligjit, prodhimin e pasojave juridike të aktit administrativ, deri në njoftimin e vendimit që zgjidh ankesën. Si dhe Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik konkretisht nenin 38 paragrafin 1 ku përcaktohet se: 1. Plotësimi i pozitave të lira në kategorinë profesionale, të ulët dhe të mesme drejtuese, bëhet së pari nga nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, nëpërmjet procedurës së lëvizjes brenda kategorisë.*

Nga sa u tha më lart, Kolegji i Këshillit ka analizuar edhe dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative përkatësisht nenin 97 paragrafi 2 të këtij ligji më të cilin është përcaktuar se: "... 2. Përfundimi i një procedure administrative të nisur sipas detyrës zyrtare është në diskrecionin e organit publik, përpos kur parashihet ndryshe me ligj dhe bëhet me akt administrativ, dhe si rrjedhojë konstatoi se Komisioni i Vlerësimit me rastin e përfundimit të procedurës së lëvizjes brenda kategorisë, duhet të nxjerr akt përfundimtar i cili duhet të përmbajë të gjitha elementet e aktit administrativ të përcaktuara me nenin 47 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Andaj, meqenëse është konstatuar se procedura e vlerësimit të kandidateve lidhur me konkursin me numër reference RN00011001 për pozitën e punës "Zyrtar i Lartë për Komunikim me Publikun" në Komunën e Prishtinës është përcjell me shkelje ligjore, Kolegji i Këshillit vlerëson së pretendimet ankimore të ankueses janë të drejta dhe të bazuara, ndërsa duke qenë së akti i shpalljes së konkursit me numër reference RN00011001 si dhe lista e ngushtë lidhur





me këtë procedurë nuk janë të përfshira me të meta procedurale dhe materiale, Kolegji i Këshillit vendosi që të anulohen të gjitha veprimet administrative të përcaktuar si në dispozitiv të këtij vendimi, me detyrimin që Komisioni i Vlerësimit në procedurë të vlerësimit të kandidatëve të merr parasysh të gjeturat dhe pikëpamjet juridike të Kolegjit.


Theksuar si më lartë, Kolegji i Këshillit duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.


**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.631/2023

Çlirim Zeka

  
Procesmbajtës

Eshref Shabani

  
Kryetar i Kolegjit



**Vendimi i dërgohet:**

- Ankueses
- Kryetarit të Komunës së Prishtinës;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Prishtinës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.